



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Nr. Prot. 03-03/621/18
Br. Prot. 03-03/621/18
Prot. No. 03-03/621/18
Nr. i faq. 03
Bros. strana 03
Prishitë 03-03-2018

DATE/A:	02.03.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-569/18
PËR/ZA/TO:	z. Liridon DALIPI, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit – Radio Televizioni i Kosovës
CC:	z. Mentor SHALA, Drejtor i Përgjithshëm – Radio Televizioni i Kosovës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Shërbimet e Hostingut për nevojat e WEB-it, të RTK-së "

I nderuari z. DALIPI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Shërbimet e Hostingut për nevojat e WEB-it, të RTK-së** ", me numër të prokurimi: RTK-18-927-221, me nr. të brendshëm: RTK-18-077-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Shërbimet e Hostingut për nevojat e WEB-it, të RTK-së** ", me numër të prokurimi: RTK-18-927-221, me nr. të brendshëm: RTK-18-077-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), me datë 28.02.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-569/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Shërbimet e Hostingut për nevojat e WEB-it, të RTK-së*", me numër të prokurimi: *RTK-18-927-221*, me nr. të brendshëm: *RTK-18-077-221*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Radio Televizioni i Kosovës - RTK.

Agjencia duke u bazuar në dokumentet e nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar me kujdes Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit ku ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka paraparë kontratë të shërbimeve të Hostingut, duke përdorur procedurën e hapur të prokurimit, kontratë publike kornizë me një Operator të llojit shërbime me vlerë të mesme të kontratës, ku hapja e tenderit është paraparë të bëhet me datën 16.03.2018.

Agjencia, gjatë analizimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit ka vërejtur se tek rubrika 9.1 dhe 9.2 *Kapaciteti teknik/profesional*, pika 1 është kërkuar: Pasqyra e projektit dhe vlera minimale referencë në lidhje me punët në **dy vitet e fundit, ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare pika 1 është kërkuar: Lista e kontratave kryesore ose referencat relevante të shërbimeve të Operatorit ekonomik të realizuara gjatë 2 viteve të kaluara, (Ndërmarrja që merr pjesë në këtë tender duhet të dëshmojë se ka ekzekutuar me sukses së paku 1 kontratë të ngjashme me këtë tender në Institucione Publike)**, kërkesë kjo për të cilën Agjencia, konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktues mundet të kërkojë kontrata dhe referenca për furnizime, shërbime dhe punë që ka realizuar Operatori Ekonomik me Institucionet Publike, Misionet Ndërkombëtare dhe Kompanitë Private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkojnë kontrata apo referenca vetëm me Institucionet Publike. Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik me saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 është paraparë që "Autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë".



Agjencia gjithashtu vëren se, në kuadër të kësaj kërkesë është kërkuar lista e kontratave kryesore ose referencat relevante të Operatorit ekonomik të realizuara gjatë 2 viteve të kaluara, kërkesë kjo për të cilën Agjencia, konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69 .

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik, Autoritetet Kontraktuese mund të kërkojnë kontrata dhe referenca për shërbime të ngjashme, por nëse vendosin në kërkesë të tillë atëherë detyrimisht duhet që kontratat dhe referencat ti kërkojnë për 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e që në këtë rast do duhej të kërkoreshin kontratat dhe referencat për tërë vitet fiskale 2015,2016 dhe 2017 e jo të kërkohej Lista e kontratave dhe referencat vetëm për dy vitet e kaluara si në rastin konkret.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Aftësitë Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !